



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.08-141

25.04.2025

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21,154/23 dhe 55/24), ndërsa në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores për Punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019 Vendimi PA1 nr.08-133 datë 17.04.2025 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1832/5 datë 24.04.2025, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 18-të mbajtur më 24.04.2025, miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup,
2. Ky vendim bohohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio, ndalon së vlefshmi me ligj, me heqjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) nga neni i cituar i Ligjit, Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ka pushuar së vlefshmi në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 17-të mbajtur më 16.04.2025 në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1752/5 datë 16.04.2025 miratoi Vendim PA1 nr.08 -133 datë 17.04.2025 me të cilën i hiqet leja Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, PA1 nr.08 -128 datë 13.03.2017 për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për të kryer veprimtarinë, respektivisht për shkak se transmetuesi nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënie e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023 dhe nuk e ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv në afatin e përcaktuar me Ligj - 30 ditë nga dita e pranimit të Faturës me nr.2025-100-0086 datë 28.02.2025 r. (ark.nr.yni 05-830/1 datë 28.02.2025).

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë (Tekst i pastruar), Vendimin PA1 nr.08-133 datë 17.04.2025 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJ P eksport – import Saraj, Shkup, PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017 dhe Konkluzionin ark.nr.datë 24.04.2025, Këshilli i Agjencisë në seancën e 18-të mbajtur më 24.04.2025, miratoi aktvendim si në dispozitiv

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.